



K.DH.SH.II.nr.1020/22

GJYKATA KOMERCIALE -Dhoma e Shkallës së Dytë, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Franciska Zhitija Ymeri, kryetare e kolegjit, Dren Rogova dhe Ramush Bardiqi, anëtar të kolegjit, në konfliktin administrativ sipas padisë së paditësit NPN “V...Sh...” me seli në Malishevë, të cilën sipas autorizimit e përfaqëson A.M., kundër të paditurës Dogana e Kosovës (DK) në Prishtinë, me bazë juridike, anulim vendimi, duke vendosur lidhur me ankesën e të paditurës, ushtruar kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë- Departamenti për Çështje Administrative, Divizioni Fiskal, A.nr.2903/18 të datës 21.01.2021, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 13.04.2023, merr këtë:

A K T G J Y K I M

REFUZOHET si e pabazuar ankesa e të paditurës Dogana e Kosovës në Prishtinë, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështjet Administrative - Divizioni Fiskal A.nr.2903/18 i datës 21.01.2021, **VËRTETOHET**.

A r s y e t i m

Gjykata e shkallës së parë me aktgjykimin e ankimuar A.nr.2903/18 të datës 21.01.2021, në pikën I. të dispozitivit e ka aprovuar si të bazuar kërkesëpadinë e paditësit NPN “V...Sh...” me seli në Malishevë. Në pikën II të dispozitivit, Anullohet pjesërisht aktvendimi me nr.07.3/1271 I datës 11.11.2018 i Doganës së Kosovës në Prishtinë. Në pikën III. Obligohet e paditura Dogana e Kosovës në Prishtinë që paditësit NPN “V...Sh...” me seli në Malishevë, t’ia kthej shumën prej 1,404.00€ (njëmijë e katërqind e katër euro e zero cent), të paguar më tepër, në emër të detyrimeve doganore, për shkak të rivlerësimit të mallit të importuar përmes Deklaratës Unike Doganore me nr.32649 të datës 18.12.2015 të proceduar në Zyrën e Brendshme Doganore Prizren, me kamatë ligjore prej 8% duke filluar nga dita e paraqitjes së padisë në gjykatë me datë 11.12.2018 e deri në pagesën definitive. Në pikën IV. Secila palë i bart shpenzimet e veta procedurale.

Kundër këtij aktgjykimi brenda afatit ligjor ankesë ka paraqitur e paditura Dogana e Kosovës për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe aplikimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që Dhoma e Shkallës së Dytë ta aprovon ankesën në tërësi si të bazuar me ligj, të prish aktgjykimin A.nr. 2903/18 të datës 21.01.2023 si të pa bazuar, ta refuzon padinë dhe kërkesën e paditësit si të pabazuar me ligj, dhe të lë në fuqi vendimin e kontestuar ose t'ia kthej gjykatës në rishqyrtim dhe rivendosje.

Gjykata Komerciale-Dhoma e Shkallës së Dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktgjykimin e ankimuar dhe vlerësimit komplet shkresave të lëndës, në mbështetje të dispozitës së nenit 194, dhe 208 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), të zbatueshëm sipas nenit 63 të Ligjit për Konfliktet Administrative dhe nenit 49 të Ligjit për Konfliktet Administrative ka gjetur se:

Ankesa e të paditurës është e pabazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësi, në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështjet Administrative - Divizioni Fiskal, me datën 11.12.2018, ka paraqitur padi për anulimin e vendimit-aktit administrativ të Doganës së Kosovë në Prishtinë nr. 07.3/1271 i datës 19.01.2016 me të cilin vendim është aprovuar pjesërisht kërkesa e subjektit në procedurë NPN "V...Sh..." Malishevë, për rishqyrtimin e vendimit numër R-32649/18.12.2015 të ZBD Prizren si pjesërisht të bazuar. Është lejuar kthimi i mjeteve të paguara më tepër, subjektit në procedurë NPN "V...Sh..." Malishevë, në xhirollogarinë rrjedhëse XK051145004454000197 të evidentuar përmes PCBK, dhe atë për Deklaratën Unike Doganore nr. R-32649/18.12.2015 të ZBD Prizren në emër të TVSH 18% githsejt 4,002.91€.

Gjykata e shkallës së parë duke vepruar sipas padisë së paditësit, me aktgjykimin A.nr. A.nr.2903/18 të datës 21.01.2021, e aprovon kërkesëpadinë e paditësit, ka anuluar pjesërisht aktvendimin kontestues nr. 07.3/1271 i datës 19.01.2016, dhe ka obliguar të paditurën që

paditësit t'ia kthej shumën prej 1,404.00€ (njëmijë e katërqind e katër euro e zero cent), të paguar më tepër, në emër të detyrimeve doganore, për shkak të rivlerësimit të mallit të importuar përmes Deklaratës Unike Doganore me nr.32649 të datës 18.12.2015 të proceduar në Zyrën e Brendshme Doganore Prizren, me kamatë ligjore prej 8% duke filluar nga dita e paraqitjes së padisë në gjykatë me datë 11.12.2018 e deri në pagesën definitive. Në arsyetim të aktgjykimit të ankimit gjykata e shkallës së parë ka theksuar se nga ekzaminimi i vendimit të kontestuar gjykata konstaton se e paditura në ri procedurë sipas aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative-Divizioni Fiskal A.nr. 185/16 i datës 10.10.2018 me aktvendimin e kontestuar ka aprovuar pjesërisht kërkesën e subjektit në procedurë NPN "V...Sh..." këtu paditësit dhe ka lejuar kthimin e mjeteve të paguara më tepër nga paditësi në emër të detyrimeve doganore për mallin e zhdoganuar përmes Deklaratës Unike Doganore R-32649/18.12.2015 të ZBD Prizren, në emër të TVSH-së në shumë prej 4,002.91€. Gjykata vlerëson se e paditura as në vendimin e parë kur ka refuzuar ankesën e paditësit dhe as në vendimin e kontestuar në këtë procedurë gjyqësore të konfliktit administrativ nuk ka arritur të mbështes në prova materiale konkrete, përmes të cilave do të mund të dëshmohej se paditësi i ka paguar eksportuesit "M...B..." Sri nga Italia mbi çmimin neto të faturës së mallit me nr. 1,343/2015 të datës 16.12.2015 në vlerë prej 5,000€ dhe transaksionit bankar të datës 10.12.2015 po ashtu në vlerëm prej 5,000€. Konstatimi i të paditurës i dhënë në vendimin e kontestuar se në shkresat e lëndës ka munguar kontrata e shitblerjes prandaj Dogana e Kosovës e ka të pamundur të pranoj vlerën transaksionale të subjektit në procedurë, për gjykatën nuk është i bazuar sepse me dispozitat e Kodit Doganor dhe të Akcizave të Kosovës nr. 03/L-109 dhe as me dispozitat e UA nr. 11/2009 për Implementimin e Kodit Doganor dhe të Akcizave nuk parashihet që kontrata e shitblerjes është dokument i cili duhet bashkangjitur deklaratës doganore për vendosje të mallit në qarkullim të lirë dhe për tu aplikuar metoda e parë e nenit 33 paragrafi 1 të KDAK-së për më tepër gjykata konstaton se paditësi për të provuar vlerën e deklaruar të mallit si provë ka paraqitur edhe faturën e shitjes së brendshme me nr. 553/2018 të datës 18.09.2018 dhe transaksionin bankar të datës 07.10.2018 nga ku shihet se paditësi mallin lëndor "kran i përdorur" marka Catttaneo, tipi CM78A numëe 8434 viti i prodhimit 2008 e ka shitur tek subjekti "A..." sh.p.k me seli në Prishtinë në shumë prej 10,850.00€ në anën tjetër e paditura për ta mbështetur rivlerësimin e mallit lëndor si provë ka paraqitur Procesin Mbi Përcaktimin e Vlerës së Mallrave të datës 18.12.2015 nga i cili nuk mund të kuptohet fare se pse është

rivlerësuar malli lëndor i deklaruar nga paditësi, në të cilat të dhëna për mallrat e ngjashme është bazuar e paditura kur ka rivlerësuar mallin, karakteristikat e mallit të ngjashëm, viti i prodhimit, pesha e mallit, funksioni, siç parashihet me nenin 61 paragrafi 1 pika d) të UA nr. 11/2009 për Implementimin e Kodit Doganor dhe të Akcizave nr. 03/L-109. Gjykata ka shqyrtuar dispozitat e nenit 123 par.1 pika a) të UA nr. 11/2009 për Implementimin e Kodit Doganor dhe të Akcizave nr. 03/L-109, ku është parashikuar që dokumenti që duhet bashkangjitur deklaratës doganore për vendosje të mallit në qarkullim të lirë është *“fatura në bazë të së cilës deklarohet vlera doganore e mallrave, siç kërkohet sipas nenit 91 të këtij akti”*. Andaj gjykata ka konstatuar se paditësi ka paraqitur faturën e blerjes së mallit si dhe transaksionin bankar, me të cilat dokumente ka dëshmuar çmimin e paguar të mallit me qëllim eksporti përkatësisht importin në Kosovë, siç kërkohet me nenin 33 paragrafi 1 të KDAK-së.

Për mënyrën e vendosjes gjykata e shkallës së parë - Departamenti për Çështjet Administrative - Divizioni Fiskal, është bazuar të nenit 81.I par. 2 pika 2.3 të Ligjit nr.04/L102 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit për ATK -në dhe Procedurat nr. 03/L-222, dhe nenit 46 par. 2 dhe 5 të Ligjit për Konfliktet Administrative.

Dhoma e Shkallës së Dytë e pranon vlerësimin juridik të gjykatës së shkallës së parë si të rregullt dhe të ligjshëm, për arsye se aktgjykimi i ankimuar me ankesë nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 1 dhe 2 pika n), ku përcakton se: *“në qoftë se aktgjykimi ka të meta për shkak të të cilave nuk mund të ekzaminohet, e sidomos në qoftë se dispozitivi është i pakuptueshëm apo kontradiktor me vetvete ose me arsyet e aktgjykimit, apo nëse aktgjykimi nuk ka fare arsye apo në të janë treguar fare arsyet për faktet vendimtare, ose ato arsye janë të paqarta, ose kontradiktore, ose nëse për faktet vendimtare ekzistojnë kundërthënie midis asaj që në arsyet e aktgjykimit thuhet për përmbajtjen e dokumentit ose procesverbalit për thëniet e dhëna në procedurë dhe të vetë atyre dokumenteve ose të procesverbalit”* e as nenit 194 të LPK -së, të zbatueshëm sipas nenit 63 të LKA -së, për të cilat Dhoma e Shkallës së Dytë kujdeset sipas detyrës zyrtare dhe as nga neni 38 të LKA -së, po ashtu nuk është i përfshirë as në shkeljet e tjera të dispozitave të procedurës administrative e as me konstatim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike.

Sa i përket pretendimeve ankimore të paditurës për shkelje esenciale të dispozitave të procedurës, këto pretendime ankimore nuk qëndrojnë, meqë gjykata e shkallës së parë ka shqyrtuar padinë, fillimisht i ka dërguar padinë përfaqësuesit të paditurës në përgjigje në padi, pastaj ka caktuar seancën e shqyrtimit kryesor, ka nxjerrë prova të mjaftueshme, që do të thotë se gjatë vlerësimit gjykata e shkallës së parë nuk ka bërë shkelje esenciale të dispozitave LKA-së, Ligjit Nr.04/L-102 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr.03/L-222 për Administratën Tatimore dhe Procedurat, Kodit Doganor dhe të Akcizave të Kosovës, si dhe të LPK-së.

Ndërsa sa i përket pretendimeve ankimore për vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, pasi që gjykata e shkallës së parë nuk ka administruar provat për të vërtetuar gjendjen faktike, por ato vetëm i ka përmendur dhe ka nxjerr një konkluzion të gabuar duke aprovuar padinë e paditësit. Këto pretendime ankimore kolegji i kësaj gjykate nuk i aprovoj, ngase të njëjtat janë të pa argumentuara dhe të pa qëndrueshme në vërtetimin e gjendjes tjetër faktike nga ajo e vërtetuar nga gjykata e shkallës së parë. Sepse e paditura me asnjë provë nuk i vërteton pretendimet e saj, ndërsa provat e prezantuara nuk janë me ndikim për vendosje ndryshe të kësaj çështje administrative juridike, për faktin se e paditura nuk ka vërtetuar drejte gjendjen faktike dhe si rezultat i kësaj edhe ka aplikuar gabimisht drejtën materiale.

Nga tërë kjo që u cekë më lartë dhe mbi këtë gjendje faktike, kjo gjykatë konsideron se gjendja faktike është vërtetuar drejtë dhe në mënyrë të plotë, ngase nuk është cenuar ligji në dëm të paditurës. Prandaj, pretendimet ankimore në ankesë se gjykata e shkallës së parë gabimisht ka aplikuar edhe të drejtën materiale në dëm të paditurës, ky kolegji nuk i aprovoi, sepse vlerësoi se të njëjtat janë të paqëndrueshme dhe të pa bazuara për tu aprovuar ankesa, dhe se janë të pa ndikim në vërtetimin e një gjendje tjetër faktike nga ajo e vërtetuar edhe nga gjykata e shkallës së parë. Sepse, aktgjykimi i ankimuar i gjykatës së shkallës së parë, është i qartë dhe i kuptueshëm si dhe përmban arsye të mjaftueshme për faktet vendimtare, të cilat i pranon edhe kjo gjykatë, andaj, ankesa e të paditurës u refuzua si e pa bazuar, ndërsa aktgjykimi i ankimuar u vërtetua si i drejtë dhe i ligjshëm. Duke marrë parasysh se gjykata e shkallës së parë, në mënyrë të drejtë ka zbatuar dispozitat procedurale dhe materiale, me rastin e aprovimit të kërkesëpadisë së paditësit, e pasi që me pretendimet tjera ankimore të përsëritura, të njëpasnjëshme, një aktgjykim i tillë nuk mund të vihet në pyetje, ankesa e të

paditurës, u refuzua si e pa bazuar, ndërsa aktgjykimi i ankimuar u vërtetua si i drejtë dhe i ligjshëm.

Mbi këtë bazë e në mbështetje të nenit 49 të LKA-së, lidhur me nenin 200 të LPK-së, të aplikueshëm sipas nenit 63 të LKA-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

K.DH.SH.II.nr.1020/22, me datë 13.04.2023

Kryetare e kolegjit,
Franciska Zhitija Ymeri